



BURIME PËR IMIGRANTËT NË NJU JORK

PAVARËSISHT NGA STATUSI JUAJ I IMIGRACIONIT, QYTETI I NJU JORKUT ËSHTË I GATSHËM T'JU NDIHMOJË.



Ndihma ligjore për imigracionin

Për ndihmë ligjore falas dhe të sigurt për imigracionin, telefononi në numrin 800-354-0365, nga e hëna deri të premten, nga 9 paradite deri në 6 pasdite.



Karta e identitetit e qytetit të Nju Jorkut

Aplikoni për një kartë IDNYC, karta falas e identifikimit e bashkisë për të gjithë rezidentët në qytetin e Nju Jorkut të moshës 10 vjeç e sipër. Rinovojeni në internet ose caktoni një takim për regjistrimin duke **telefonuar në 311** ose duke vizituar **nyc.gov/idnyc**.



Kurset e gjuhës angleze

Mësoni **anglisht falas** në çdo kohë dhe në çdo vend. Vizitoni **wespeaknyc.cityofnewyork.us** për më shumë informacione.



Kujdesi shëndetësor

NYC Health + Hospitals (H+H) H+H mund të ofrojë kujdes në rast urgjencash, kujdes shëndetësor bazë, kontrole të përgjithshme, vaksinime imunizimi dhe më shumë. **Telefononi në numrin 718-387-6407 për t'u drejtuar te qendra më e afërt për ju.** Për t'u regjistruar në planet e sigurimit shëndetësor, duke përfshirë programin **NYC Care**, telefononi në **646-NYC-CARE (646-692-2273)** ose vizitoni **nyccare.nyc**



Shëndeti mendor

Për mbështetje konfidenciale dhe lidhje me burimet për kujdesin për shëndetin mendor dhe përdorimin e substancave, **telefononi në 888-692-9355 ose 988, dërgoni mesazh me "WELL" te 65173** ose vizitoni **mentalhealthforall.nyc.gov**



Urgjencat

Në rast urgjence, telefononi në numrin 911. Një urgjencë është çdo situatë që kërkon ndihmë të menjëhershme nga policia, departamenti i zjarrfikëses ose ambulanca. **Sipas ligjit, Departamenti i Policisë i Qytetit të Nju Jorkut nuk mund të pyesë për statusin e imigracionit të viktimave të krimeve, dëshmitarëve në to ose të personave të tjerë që kërkojnë ndihmë.**



Arsimi publik

Të gjithë fëmijët e moshës 4-21 vjeç në qytetin e Nju Jorkut mund të ndjekin shkollën publike. Për t'u regjistruar, vizitoni **schools.nyc.gov/fwc** ose **telefononi në 311**.



Burime dhe informacione të përgjithshme për qytetin

Keni nevojë për akses në burimet e qytetit ose dëshironi të raportoni një problem? Telefononi në **311** ose vizitoni **portal.311.nyc.gov**



Linja telefonike për çështjet e imigrantëve në qytetin e Nju Jorkut

Telefononi në linjën tonë telefonike në 212-788-7654 nga e hëna deri të premten, nga 9 paradite deri në 5 pasdite, ose na dërgoni një email në **askmoia@cityhall.nyc.gov**



BURIME PËR IMIGRANTËT NË NJU JORK

PAVARËSISHT NGA STATUSI JUAJ I IMIGRACIONIT, JU KENI TË DREJTAT.

Shmangni mashtrimet në lidhje me imigracionin

Nëse keni nevojë për këshilla ligjore për imigracionin, shkoni vetëm te një avokat i licencuar ose një përfaqësues i akredituar. Mund ta gjeni listën e ofruesve të akredituar dhe të njohur në nyc.gov/immigrants.

Të drejtat për zbatimin me forcë në lidhje me imigracionin

Qyteti i Nju Jorkut nuk kryen zbatimin me forcë në lidhje me imigracionin. Nëse kontaktoheni nga përfaqësues të zbatimit me forcë në lidhje me imigracionin, ju keni të drejtat tuaja. Vizitoni nyc.gov/knowyourrights ose telefononi në qendrën telefonike ligjore falas në lidhje me imigracionin në numrin **800-354-0365**.

Të drejtat e punëtorëve

Ju keni të drejtat për leje të paguar në rast sëmundjeje, për pagën minimale, pagesën për kohën shtesë dhe më shumë sipas ligjeve të qytetit të Nju Jorkut. Vizitoni nyc.gov/workers për burime ose telefononi në **212-436-0381**.

Raportoni diskriminimin

Ngacmimi dhe diskriminimi janë të paligjshëm sipas ligjit për të drejtat e njeriut në qytetin e Nju Jorkut. Për të raportuar një incident në lidhje me diskriminimin, telefononi në **212-416-0197**.

Mbrojtjet ndaj dhunës në familje

Qyteti i Nju Jorkut është i gatshëm t'ju ndihmojë nëse jeni objekt i abuzimit. Mund të vizitoni nyc.gov/nychope ose mund të telefononi në linjën telefonike për dhunën në familje të qytetit të Nju Jorkut në **800-621-HOPE**.

Të drejtat e qiramarrësit

Keni nevojë për ndihmë për çdo çështje në lidhje me dëbimin ose qiradhënësin? Vizitoni nyc.gov/tenantprotection ose telefononi në **311** dhe thoni "tenant helpline" për ndihmë ligjore falas.

E drejta e strehimit

Ju keni të drejtën të kërkonti strehim nëse jeni të pastrehë. Mund të keni akses te shërbimet e strehimit duke vizituar qendrën përkatëse pritëse të DHS-së. Mësoni më shumë duke telefonuar në **311**.

Mbrojtja e konsumatorit

Keni një problem me një biznes? Si konsumator, ju keni të drejtat tuaja. Paraqitni një ankesë duke vizituar nyc.gov/consumers ose telefononi në **311**.